

MENDIME RRETH EKZISTENCËS SË PERËNDISË

Në qendër të një qyteti gjendet një ndërtesë shumë e madhe, që shërben si «Muze i Ateizmit»¹. Ateistët vendosën që të grumbullonin dhe të paraqitnin në muze gjithë faktet që, sipas tyre, do të provonin me siguri të plotë se Perëndia nuk ekziston. Çdo vit këta ateistë ftonin me mijra nxënës shkollash dhe të rritur për të vizituar muzeun dhe përiqeshin t'i bindnin se besimi në Perëndi është i kotë. Ata tallnin dhe ngacmonin të gjithë ata që vazhdonin të besonin në Perëndinë.

Shumica e njerëzve në Shqipëri sot nuk besojnë në ekzistencën e Perëndisë. E vërteta është se, kohë më parë, shqiptarët kanë qenë shumë herë më besimtarë se sa janë sot. Por sot çdo gjë ka ndryshuar në Shqipëri! Shumë njerëz mendojnë se të besosh në Perëndi është e njëjta gjë si të besosh në një përrallë. Fatkeqësisht, fëmijët në Shqipëri rriten duke mësuar nga shkolla dhe nga televizori se Perëndia nuk është krijuesi i botës, se Ai nuk ekziston dhe se e mira dhe e keqja janë gjëra relative që njerëzit mund t'i interpretojnë si të duan.

A mund ta dimë me siguri nëse Perëndia ekziston? Shumë vetë duan ta dinë përgjigjen e kësaj pyetjeje. Përgjigjja është *po!* Ne mund të provojmë se Perëndia jeton, se Ai është i vërtetë dhe se Ai i do të gjithë njerëzit dhe kujdeset për secilin prej tyre! Ai që me ndershmëri kërkon të vërtetën rreth Perëndisë do të mund të thotë ashtu si tha profeti Jeremia: «Por Zoti është Perëndia i vërtetë, ai është Perëndia i gjallë dhe mbreti i përjetshëm»

(Jeremia 10:10). Më poshtë jepen disa fakte që na ndihmojnë të kuptojmë ekzistencën e Perëndisë.

SHIKONI NATYRËN

Psalmeve 19:1–6 është një poemë e bukur që lëvdon ekzistencën e Perëndisë. Në këtë poemë, autori ka shfrytëzuar dy burime për të treguar ekzistencën e Perëndisë, natyrën dhe dhuratën e frymëzuar të Perëndisë për ne, Biblën:

Qiejtë tregojnë lavdinë e Perëndisë dhe kupa qiellore shpall veprën e duarve të Tij.
Një ditë i flet ditës tjetër dhe një natë ia tregon tjetrës.
Nuk kanë gojë, as fjalë;
Zëri i tyre nuk dëgjohej;
Por harmonia e tyre përhapet mbi gjithë dheun dhe mesazhi i tyre arrin deri në skajin e botës;
Në qiejtë Perëndia ka vënë një çadër për diellin;
Dhe ai është si një dhëndër që del nga dhoma e tij e martesës;
Ngazëllon si një trim që përshkon rrugën e tij.
Ai del nga një skaj i qiejve dhe rrotullimi i tij arrin deri në skajin tjetër;
Asgjë nuk mund t'i fshihet nxehtësisë së tij.

Kjo poemë e bukur tregon se sa shumë qiejtë me madhështinë e tyre dëshmojnë për ekzistencën e Perëndisë. Kur shikojmë lart në qiell (diellin, hënën dhe yjet), ne shikojmë veprën e lavdishme të duarve të Perëndisë. Gjatë gjithë ditës dhe gjatë gjithë natës qiejt shpalosin dëshminë e ekzistencës së Perëndisë. Ato e bëjnë këtë pa fjalime, pa fjalë dhe pa zë.

Bukuritë e mrekullueshme të natyrës shërbejnë si një dëshmi e madhe dhe e pamohueshme e ekzistencës së Perëndisë. Natyra vetëm duhet të mjaftonte për t'ua mbyllur gojën atyre që thonë se Perëndia nuk ekziston.

SHIKONI NJERIUN

Njeriu në vetvete është në gjendje të dallojë të mirën nga e keqja dhe kjo aftësi për të dalluar vjen nga Perëndia. Si mund ta dallojmë të mirën nga e keqja përveç se me anë të «ndërgjegjes» që na ka dhënë Perëndia? Por mund të ndodhë që me kalimin e kohës ne mund të arrijmë në atë shkallë sa të mos e njohim më të keqen bile edhe ta aprovojmë atë. Por kjo nuk ndryshon faktin se ne lindëm me aftësinë për të dalluar të mirën nga e keqja. Perëndia që jeton në qiell ia ka dhënë ndërgjegjen çdo njeriu!

Gjithashtu, njeriu në vetvete ka të trashëguar ndjenjën e nderimit dhe kjo është një dëshmi tjetër e ekzistencës së Perëndisë. Çdo qytetërim, fis apo grup njerëzish që ka ekzistuar në histori ka nderuar dhe adhuruar diçka në një formë apo tjetër. Instiktivisht njeriu shikon lart drejt Qenies më të madhe. I vetmi shpjegim për këtë është se Perëndia e pajisi njeriun me dëshirën e të nderuarit.

Mendoni me kujdes për trupin njerëzor, rreth mënyrës se si është krijuar dhe funksionimin kompleks të tij. Çdo njeri që do ta bënte këtë do të zbulonte ekzistencën e Krijuesit të plotfuqishëm. Davidi u shpreh kështu për trupin e tij: «Unë do të të kremtoj, sepse jam krijuar në mënyrë të mrekullueshme» (Psalmeve 139:14). Dëshiroj që të gjithë ne sot të mund të arrijmë në të njëjtin përfundim që arriti Davidi.

SHIKONI GJITHËSINË

Kam dëgjuar një histori interesante për Benjamin Franklin, një nga presidentët më të shquar të SHBA. Franklin, para se të bëhej president, ishte ambasador i SHBA në Francë. Gjatë kësaj kohe ai ishte anëtar i një klubi shkencor të nivelit të lartë. Në takimet që organizonte ky klub, Franklin kishte dëgjuar pohime të ndryshme kundër ekzistencës së Perëndisë, prej të cilëve të jepej përshtypja se vetëm njerëzit me paragjykime dhe të pa shkollë mund të besonin akoma se Perëndia është Krijuesi i gjithësisë. Franklin solli në një takim një model të bukur të sistemit diellor. Me të vërtetë modeli ishte bërë me mjeshhtëri. Një nga anëtarët që nuk besonte në Perëndi

e pyeti: «Kush e bëri modelin?» «Asnjëri! U krijua vetë», u përgjigj Franklin me ironi. Mënyra më e mirë për të shpjeguar ekzistencën e gjithësisë është se Perëndia e krijoi atë!

Mbreti i fuqishëm David duke shikuar qiejt, hënën dhe yjet, pa në ta punën e duarve të Perëndisë. Ai shkroi:

Sa i mrekullueshëm është emri yt mbi gjithë rruzullin,
o Zot, Zoti ynë, që vure madhësitinë tënde mbi
qiejtë!

Kur mendoj qiejtë e tu, që janë vepër e gishtërinjve
të tu, hënën dhe yjet që ti ke vendosur,
çfarë është njeriu, që ta mbash mend, dhe biri i
njeriut, që ta vizitosh? (Psalmeve 8:1, 3, 4).

Gjithçka që ndodhet në gjithësi është krijuar në një moment të kohës. Momenti i fillimit ishte kur Perëndia krijoi çdo gjë, ashtu si tregohet në kapitullin e parë të Zanafillës, që është libri i parë në Bibël. Natyrisht ekzistenca e kësaj gjithësie të mrekullueshme, në të cilën jetojmë, qëndron si një dëshmi e madhe e ekzistencës së Perëndisë.

MENDONI PËR PLANIN E PERËNDISË

A keni parë ndonjëherë nga brenda një orë dore apo motorin e një autoveture? Në qoftë se po, me siguri keni vënë re se mekanizmat, që e vënë në lëvizje orën apo motorin, bashkëveprojnë dhe lëvizin në një mënyrë të caktuar. Arsyeja për këtë lëvizje është se këto pjesë të veçanta janë krijuar që të funksionojnë në atë mënyrë. Pajisjet e ndërlikuara nuk funksionojnë rastësisht. Ne mund të themi me siguri se çdo pajisje apo objekt i ndërlikuar ka qenë projektuar dhe ndërtuar nga dikush. Me pak fjalë, ne duhet ta pranojmë që gjithçka që ekziston provon ekzistencën e krijuesit të saj. Mund ta përdorim këtë lloj arsytimi gjithashtu për ekzistencën e Perëndisë. Në qoftë se ne vërejmë disa objekte të caktuara, pjesë apo lëvizje të cilat s'mund të ndodhin aksidentalisht, atëherë duhet të pranojmë se një Planifikues suprem i përgatiti dhe i vuri këto sisteme në lëvizje.

Projekti për formën dhe funksionimin e trupit njerëzor është i mrekullueshëm. Mendoni për një moment për punën që bëjnë në trup sistemi i qarkullimit të gjakut, sistemi për typës, sistemi i sekretimit të lëngjeve, sistemi i frymëmarrjes dhe gjithë sistemet e tjera që nevojiten për një funksionim të duhur të trupit tonë. Këto sisteme janë një mijë herë më të komplikuar se një orë e thjeshtë. A u

krijuan ato aksidentalisht? A mund të shpjegohet pa Perëndinë saktësia e madhe që kanë këto sisteme? Natyrisht, në qoftë se pranojmë se një orë e thjeshtë dore është krijuar nga dikush, atëherë duhet të pranojmë se trupi njerëzor gjithashtu e ka një Krijues!

Shumë shembuj të veprës së mrekullueshme të Perëndisë gjenden në trupin njerëzor. Përshtatja e menjëhershme e fëmijëve të porsalindur me kushtet e reja të ambjentit është një shembull tjetër që jep dëshmi se Perëndia ekziston dhe se Ai i krijoi trupat tanë. Fëmija që është akoma në trupin e nënës së vet nuk ka nevojë të marrë frymë, meqenëse e merr oksigjenin nga nëna. Kështu, zemra e foshnjës së palindur nuk është e ndarë në pjesë të veçanta për gjakun e papastër dhe për atë me oksigjen e të pastër. Por, në vend të kësaj ndarjeje ka dy rrugë të tjera në sistemin qarkullues të foshnjës së palindur. Një nga këto rrugë është një hapësirë e vogël midis barkushes së djathtë e të majtë në zemrën e foshnjës, e cila e lejon gjakun që në mënyrë të lirshme të qarkullojë midis dy dhomave. Rruga tjetër është një damar i shkurtër e i trashë që lidh aortën pulmonare me aortën e madhe që mundëson kalimin e gjakut me oksigjen në të gjithë pjesët e trupit. Këto dy rrugë janë krijuar për t'i shërbyer vetëm foshnjës së palindur. Pas lindjes ato nuk përdoren më. Menjëherë pas lindjes, një membranë mbyll kalimin midis aortave, për të mos u hapur më. Me kalimin e kohës një membranë e re mbështjell hapësirën e kalimit për të parandaluar përzierjen e gjakut të papastër me atë të pastër. Rrugëkalimi i dytë është pajisur me një muskul që tkurret vetëm një herë gjatë jetës. Menjëherë pasi mushkëritë mbushen me ajër, në momentin e lindjes të foshnjës, ky muskul mblidhet për të mbyllur tërësisht damarin që përdorej si rrugëkalim. Kjo bën që gjaku të rrjedhë në mushkëri dhe atje të pasurohet me oksigjen. Ky shembull tregon se sa i ndërlikuar dhe, në të njëjtën kohë, se sa i përkryer është trupi i njeriut. Të gjitha këto na thonë se një *Krijues suprem* ka nën kontroll çdo gjë dhe planet e tij janë vënë në jetë!

Plani për tokën është i jashtëzakonshëm. Ne tashmë kemi lexuar disa pjesë nga Bibla që tregojnë se toka dëshmon ekzistencën e Perëndisë. Në fakt, shkenca e përforcon këtë dëshmi, duke treguar se toka nuk mund të jetë krijuar aksidentalisht. Toka është një kryevepër e duarve të Perëndisë. Ajo zë vendin e duhur në gjithësi, korja e saj është rregulluar

që të jetë jo më shumë se tre metra dhe në qoftë se niveli i oqeanit do të ishte vetëm disa metra më i lartë ne nuk do të kishim oksigjen apo bimësi. Toka bën një rrotullim të plotë rreth vetes në 24 orë. Në qoftë se ky rrotullim do të ngadalësohej apo do të shpejtohej, atëherë jeta në këtë planet do të ndryshonte rrënjësisht. Dielli ka madhësinë, temperaturën, rrezatimin dhe densitetin e duhur për të mundësuar jetën në tokë. Përbërja e gazeve në atmosferë është e rregulluar në mënyrë të tillë që edhe një ndryshim shumë i vogël mund të jetë katastrofik për njerëzimin. Të gjitha këto fakte, dhe shumë të tjera që mund të sjellim, nuk mund të jenë rezultat i rastësisë. Toka flet për ekzistencën e Perëndisë, ashtu si lexuam te Psalmeve 19:1–6. Plani për tokën mund të ketë ardhur vetëm nga Perëndia.

KONKLUZIONI

Edhe pse kemi përmendur vetëm disa nga shembujt e panumërt të ekzistencës së Perëndisë, ne besojmë se ju tashmë keni një material të mjaftueshëm për të njohur dhe pranuar ekzistencën e Tij. Është e vështirë të besosh se një njeri pasi shikon universin, trupin njerëzor dhe natyrën prapë nuk beson në ekzistencën e Perëndisë!

Perëndia na ka dhënë prova të mjaftueshme në mënyrë që ne të besojmë në ekzistencën e Tij. Perëndia kurrë nuk përpiket të vërtetojë apo të argumentojë ekzistencën e Tij. Ai thjesht deklaron se është, se ekziston. Perëndia e quan njeriun që nuk beson në Të «të pamend»: «I pamendi ka thënë në zemër të Tij: “Nuk ka Perëndi”» (Psalmeve 14:1). Perëndia na ka dhënë kaq shumë prova për ekzistencën e Tij sa një njeri që shikon krijimet e Tij dhe nuk beson konsiderohet si «i pamend».

Perëndia trishtohet që shumë njerëz nuk dëshirojnë të hapin sytë dhe të shikojnë se Ai ekziston dhe si rrjedhim t'i binden Atij. Izraeli ishte kombi i zgjedhur i Perëndisë, por prapë nuk iu bind Atij. Perëndia i quajti izraelitët njerëz «të pamend dhe të pazemër», provat ishin përpara tyre, por ata nuk donin të besonin (Jeremia 5:21–29). Perëndia tha se Izraeli duhet të kishte frikë dhe t'i bindej Atij për arsye të fuqisë së Tij. Ai i mbrojti ata, Ai u dërgoi atyre shiun dhe i bekoji me të korrat. Prapë, Izraeli nuk iu bind dhe nuk donte ta ndiqte Perëndinë.

Le të jemi sot jashtëzakonisht të kujdesshëm për të mos u bërë si Izraeli! Ne mund të shikojmë

fuqinë e madhe të Perëndisë, ne mund të marrim bekimet dhe dashurinë e Tij. Ne duhet t'i përgjigjemi ftesës që na ka ofruar Perëndia i madh në qiell! I njëjti Perëndi që me dashuri dhe me kujdes krijoi jetën dhe tokën ka krijuar gjithashtu një plan të mrekullueshëm për shpëtim dhe ia ka ofruar këtë plan çdo njeri prej nesh, mua dhe ty, për të na shpëtuar nga mëkatet² tona. Ne mund të përfitojmë nga plani i Perëndisë për shpëtim vetëm pasi të besojmë se Krishti është Biri i Perëndisë (Veprat 8:36–37), të pendohemi për mëkatet që kemi kryer në të kaluarën (Veprat 2:37–38), të pohojmë besimin tonë përpara njerëzve të tjerë (Mateu 10:32) dhe të pagëzohemi duke u zhytur në ujë (Veprat 22:16). Të gjithë mund të sigurohen se Perëndia ka një plan për ta. Plani i Perëndisë gjithashtu përfshin jetën tonë pas vdekjes. Ne do të shndërrohemi në trupa të tjerë dhe do të jetojmë përjetë (1 Korintasve 15:35–54; 2 Korintasve 5:1), ose me Të ose larg Tij.

Perëndia ekziston. Ai është i vërtetë, i gjallë dhe

i pranishëm kudo. Ekzistenca e Perëndisë shikohet në mësimet e qarta të Biblës, në shembujt e shumtë nga natyra dhe në dëshminë që shfaq trupi ynë. Pasi të kesh mësuar këto fakte, me ndershmëri pyet veten: «A i bindem tërësisht Perëndisë? A po jetoj çdo ditë i ndërgjegjshëm se Ai ekziston? Ai e di se çfarë dëshiron Perëndia që unë të bëj dhe a e zbatoj unë këtë vullnet të Perëndisë praktikisht në jetën time?»

SHËNIME

¹ Ateizmi është një rrymë filozofike që mohon ekzistencën e Perëndisë. Ateist quhet çdo njeri që nuk beson në ekzistencën e Perëndisë.

² Mëkati është moszbatimi dhe thyerja e ligjeve të Perëndisë (që gjenden në Bibël).

Mëkati është një veprim apo mendim që është kundër ligjeve dhe natyrës së Perëndisë. Ka vetëm një rrugë për të njohur Perëndinë: leximi dhe studimi i Biblës, e cila është mesazhi i tij për njerëzit. Mëkat është për shembull të mos i bindesh Perëndisë, të vjedhësh, të gënjesh, të mos u bindesh prindërve (fëmijët), korrupsioni (shfrytëzimi i postit për qëllime përfitimi), çfarëdo lloj thyerje e ligjit, e të tjera si këto.

Autor: *John L. Kachelman, Jr.*
Marrë nga studimi: *"Perëndia kundër ateizmit"*
© 2002, 2003 E VERTETA PER SOT
Të gjitha të drejtat të rezervuara